



Z. Hivzi Demiri
Pronar
TV Liria
Ferizaj

Ref:0705/0411/EXD/II

VENDIM

Lidhur me kërkesën e TV Liria për ndryshimin e kanalit të transmetimit.


1. Më 30 janar 2007 TV Liria ka paraqitur një ankesë tek KPM lidhur me ndërhyrjet që po i shkaktohen këtij subjekti transmetues. Gjithashtu, TV Liria ka bërë kërkesë edhe për ndërrimin e kanalit të transmetimit, kalimin nga kanali 30, nga i cili i është licencuar, në kanal 25.
2. Arsyeja e kërkesës së tillë nga TV Liria, ishte evitimi i ndërhyrjes në kanal 30 nga TVM2, subjekt transmetues i cili operon nga Maqedonia.
3. Në konsultim me inxhinierët e Divizionit të Menaxhimit Frekuencor (DMF) pranë Komisionit të Pavarur për Media (KPM), kemi ardhur në përfundim se mundësia e vetme për t'i ofruar zgjidhje Televizionit Liria është ndërrimi i kanalit të këtij subjekti transmetues nga kanali 30 duke kaluar me transmetim në kanal 29.
4. DMF konstatoi se TV Liria-s t'i lejohet të fillojë transmetimin në kanal 29, që është kanal i lirë për të transmetuar në Ferizaj.
6. Lidhur me propozimin e KPM-së është pajtuar edhe TV Liria, si dhe pas marrjes së pëlqimit nga ana e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media me datën 17 prill 2007 që të merrem me këtë rast të TV Liria-s, lëshoj këtë:

Vendim

7. Lejohet që TV Liria të bëjë ndryshimin e kanalit të transmetimit duke kaluar nga kanali 30 në kanal 29.
8. Ky ndërrim i kanalit të transmetimit do të reflektojë vetëm në ndryshimin e Pjesës 2 të licencës, ndërsa zona e mbulimit do të mbetet e njëjtë ashtu siç është e përcaktuar në Pjesën 4 të licencës së TV Liria.

Vërtetim

9. Me këtë KPM vërteton dhe lëshon këtë vendim


Naile Selimaj Krasniqi,
Shefe Ekzekutive
Komisionit të Pavarur për Media



02.05.2007
Data